

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hasan Shala, kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve: Mediha Jusufi dhe Gani Avdiu, - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditëses Dogana e Kosovës “Veternik I” Zona Industriale-Prishtinë, kundër të paditurve “NN”, “ N.T.SH” Rr. “...” nr. 18 në Pejë, “NN. II”, “ N.T.SH” Rr. “...”- Pejë, me bazë juridike anulimin i kontratës, vlera e kontestit 2.181,200 euro, duke vendosur lidhur me ankesat e përfaqësuesit të paditëses, të ushtruara kundër aktvendimeve të Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.972/2013 të datës 13.10.2014 dhe 12.11.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt. 07.12.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditëses Doganat e Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Drejtësisë, gjersa aktvendimi i Gjykatës Themelore Pejë, C.nr.972/2013 i datës 13.10.2014, **VËRTETOHET**.

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditëses Doganat e Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Drejtësisë, gjersa aktvendimi i Gjykatës Themelore Pejë, C.nr.972/2013 i datës 12.11.2014, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë, C.nr.972/2013 të datës 13.10.2014, I. E konsideron të tërhequr padinë e paditëses Dogana e Kosovës, “Veterniku 12 Zona Industriale Prishtinë, e ushtruar kundër të paditurave “NN ” -N.T.Sh. “...” nr.18 në Pejë, dhe NN.-II ” -N.T.Sh. “...” tek Stacioni i Autobusëve në Pejë, baza juridike anulim i kontratës vlera e kontestit 2.181.200 euro. II. Detyrohet paditësja Dogana e Kosovës “Veterniku I” Zona Industriale-Prishtinë, që të paditurave NN- ” N.T.Sh. “...” nr.18 në Pejë, në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën prej 135 euro, ndërsa të paditurës NN-II ” -N.T.Sh. Rr. “...” tek Stacioni i Autobusëve në Pejë, shumën prej 374 euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij aktvendimi e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. III. Masa e përkohshme për sigurimin e

kërkesëpadiisë e caktuar me aktvendimin e dt. 22.10.2013, nën shenjën C.nr.972/13, lihet në fuqi gjer sa aktvendimi nga pika I. të mos bëhet i formës së prerë.

Gjykata Themelore në Pejë, C.nr.972/2013 të datës 12.11.2014, Hedhet si e pasafatshme kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë, Departamentit ligjor, divizioni për përfaqësime ligjore, për kthimin e gjendjes së më parshme në çështjen e përfunduar me aktvendimin C.nr.972/13 dt. 13.10.2014.

Kundër aktvendimit C.nr.972/13 dt. 13.10.2014, ka paraqitur ankesë përfaqësuesi i paditëses, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që aktvendimin e atakuar të ndryshoj duke e aprovuar në tërësi kërkesëpadiinë e paditësit si të bazuar, apo që aktvendimin e atakuar të prishë dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kundër aktvendimit C.nr.972/13 të dt. 12.11.2014, ka paraqitur ankesë përfaqësuesi i paditëses, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që aktvendimin e atakuar të ndryshoj duke e aprovuar në tërësi kërkesëpadiinë e paditësit si të bazuar, apo që aktvendimin e atakuar të prishë dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, pasi që i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimet e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

- Ankesat janë të pabazuara -

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja Doganat e Kosovës, ka ushtruar padi, për anulimin e kontratës së shitë blerjes me nr. rendor LRP.411/2013 dhe LRP47/2013, e vërtetuar nga noteri A.A. nga Peja, kundër të paditurve "NN" N.T.Sh. dhe "NN II", N.T.Sh. Pejë, gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor ka ftuar ndërgjyqësit, mirëpo edhe pse paditësja ishte ftuar në mënyrë të rregullt, në seancën e shqyrtimit kryesor me dt. 13.10.2014, e njëjta ka munguar dhe se mungesën nuk e ka arsyetuar. Gjykata me aktvendimin C.nr.972/2013 të dt. 13.10.2014, e konsideron të tërhequr padinë e paditëses konform nenit 423 par.3 të LPK-së.

Përfaqësuesi i paditëses ka ushtruar kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme me dt.29.10.2014, me arsyetim se gjykata e shkallës së parë me rastin e nxjerrjes së aktvendimit C.nr.972/13 të dt. 13.10.2014, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore si dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nenit 68 par.1, për pezullimin e procedurës për 180 ditë sipas këtij ligji. Gjykata jashtë seance e hedhë si të pasafatshme kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë, Departamenti Ligjor Divizionit për përfaqësime

ligjore për kthim në gjendje të mëparshme në çështje të përfunduar me aktvendimin C.nr.972/13 të dt. 13.10.2014.

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktvendimi i ankimuar C.nr.972/13 të dt. 13.10.2014, nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore 182.2 të LPK-së, si dhe dispozita e nenit 423.3 të LPK-së, kur gjykata cakton seancën shqyrtimit kryesor dhe pala paditëse nuk vjen edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt, gjykata e konsideron padinë e tërhequr përveç në rast kur i padituri kërkon që seanca të mbahet. Në rastin konkret përfaqësuesi i paditëses ka munguar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar ndërsa përfaqësuesit e të paditurve kanë marrë pjesë në seancë por nuk ka kërkuar që të mbahet seanca. Me dispozitën e cekur më lartë është paraparë pasoja e mungesës së palës në seancën e shqyrtimit kryesor. Kështu, mungesa e përfaqësuesit të paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor tërheq në vetë presumpcionin e tërheqjes së padisë, kurse mungesa e të paditurit sjell deri te mbajtja e seancës së shqyrtimit kryesor pa praninë e tij. Andaj për tu konsideruar si e tërhequr padia duhet të plotësohet vetëm një kusht mungesa e paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor, ftesa t'i bëhet e rregullt dhe mungesën mos ta arsyetoj paditësi apo përfaqësuesi i tij. Për caktimin e ligdhënësit për një zgjidhje të tillë duhet kërkuar në faktin se procedura kontestimore iniciohet me vullnetin ekskluziv të palës paditëse, prandaj vazhdimi i procedurës pa pjesëmarrjen e paditësit nuk do të kishte kurrfarë kuptimi. Përveç kësaj është në interesin e paditësit që procedura të përfundojë në afat sa më të shkurtë, andaj sjellja pasive e paditësit në raport me kontestin është tregues se paditësi e ka humbur interesin për vazhdimin e mëtejshëm të kontestit. Andaj duke marrë parasysh të cekurat më lartë gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur ka zbatuar dispozitat e nenit 423.3 të LPK-së, duke konsideruar si të tërhequr padinë e paditëses, meqë përfaqësuesi i paditëses ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt dhe se ky fakt mund të vërtetohet me fletë kthesë të dt. 11.09.2014. Nga kjo rezulton se përfaqësuesi i paditëses ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt dhe se i njëjti mungesën nuk e ka arsyetuar. Andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka konsideruar të tërhequr padinë e paditëses konform nenit 423.3 të LPK-së.

Sa i përket pretendimeve ankimore të përfaqësuesit të autorizuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, se gjykata e shkallës së parë C.nr.972/13 të dt. 13.10.2014, nuk ka zbatuar Ligjin 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë si dhe Ligjin nr.03/L-221 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë të nenit 68 par.1 i po këtij ligji. Ky pretendim nuk është i bazuar meqë sipas nenit 67 të po këtij ligji e përcakton saktë nëse, në cilindo kohë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, një person ose organizatë paraqet në gjykatë ose tribunal të arbitrazhit, një ankesë ose kërkesë kundër një autoriteti publik me anë të së cilës kërkohet kompensim monetar ose kompensim tjetër nga autoriteti publik, apo një ankesë ose kërkesë me të cilën pretendohet një e drejtë në ose mbi pronën e cila është në pronësi ose posedim të një autoriteti publik, ose nën administrimin e një autoriteti publik, personi ose organizata në fjalë, (parashtruesi i ankesës) duhet t'i siguroj një kopje të kësaj anekese ose kërkesë autoritetit përkatës publik, ministrit të drejtësisë dhe ministrit

të ekonomisë dhe financave. Nga kjo dispozitë rezulton se këtë obligim e ka gjithmonë pala paditëse kur një autoritet publik është i paditur. Mirëpo në rastin konkret këtu në cilësi të paditurit është në fakt janë ndërmarrjet “NN” N.T.SH” dhe “NN. II”, “ N.T.SH” gjersa në cilësi të paditësit është Doganat e Kosovës, që do të thotë se gjykata nuk ka pasur obligim që të veproj sipas dispozitës së nenit 67 të Ligjit për Menaxhimin e Financave dhe përgjegjësisë. Gjithashtu në bazë të nenit 68 të po këtij ligji ku thuhet se nëse në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ka raste të pa zgjidhura në gjykatë që bazohen në një ankesë ose kërkesë të përshkruar si në paragrafin 1 të nenit 67 të cituar më lartë të po këtij ligji dhe Ministria e Drejtësisë nuk është pjesëmarrës në këtë rast: Rasti për nga pikëpamja juridike, automatikisht pezullohet dhe cilido autoritet publik ose gjykatë e cila ishte e përfshirë në rastin e pazgjidhur ose një rast të mëhershëm i cili ndërlidhet me këtë çështje, menjëherë duhet ta njoftoj Ministrinë dhe Ministrinë e Drejtësisë, mbi rastin dhe duhet tu siguroj këtyre ministrive një kopje të plotë të lëndës. Pezullimi vazhdon deri në skadimin e një afati prej 180 ditësh, i cili fillon me datën kur kopja e lëndës gjyqësore i është dorëzuar të dy ministrive. Meqenëse kjo dispozitë i referohet dispozitës së nenit 67 par.1 e njëjta gjë vlen edhe sipas kësaj dispozite se gjykata ka obligim si dhe pala paditëse t’i njoftoj ministrinë dhe pezulloj procedurën vetëm atëherë kur është ushtruar ankesë ose kërkesë kundër një autoriteti publik, e në rastin konkret këtu nuk kemi asnjë ankesë as kërkesë e as padi kundër një autoriteti publik, por këtu kemi një padi të cilën e ka ushtruar autoriteti publik siç janë Doganat e Kosovës, dhe e njëjta ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt dhe përfaqësuesi i saj ka marrë pjesë në seancën e shqyrtimit kryesor, i cili përfaqësues ka pasur mundësi që të deklarohet para gjykate apo të njoftoj gjykatën se Doganat e Kosovës do të përfaqësojnë përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, mirëpo këtë të njëjtit nuk e kanë bërë dhe për seancën kur gjykata ka konstatuar tërheqjen e padisë, përfaqësuesit e Doganës kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt dhe të njëjtit nuk e kanë arsyetuar mungesën. Andaj, me të drejtë gjykata ka vendosë konform nenit 423.3 të LPK-së duke konsideruar të tërhequr padinë e paditëses.

Aktvendimi i ankimuar C.nr.972/13 i dt.12.11.2014, me të cilin është hedhë si e pasafatshme kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme, nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182 par 2 të LPK-së, për arsye se është i kuptueshëm, i çart dhe se përmban arsye të mjaftuara bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe për shkak të hetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike e cila nuk vihet në dyshim me asnjë pretendim ankimor. Për shkak se propozimi për kthim në gjendje të mëparshme ushtrohet nëse pala nuk shkon në seancë apo e humb afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural si në rastin konkret kur përfaqësuesi i palës paditëse nuk ka marr pjesë në seancën e shqyrtimit kryesor, edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt nuk e ka arsyetuar mungesën. Aktvendimin C.nr.972/13 dt. 13.10.2014, mbi konstatimin e tërheqjes së padisë, pala paditëse e ka pranuar me dt. 21.10.2014, gjersa kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme e ushtruar në gjykatë për këtë çështje është

ushtuar me dt. 29.10.2014, që do të thotë se propozimi për kthim në gjendje të mëparshme është ushtuar në gjykatë pas afatit ngase me nenin 130.2 të LPK-së, është përcaktuar: Se propozimin për kthim në gjendje të mëparshme pala mund të ushtroj brenda afatit prej 7 ditësh, nga dita kur ka pushuar shkaku i mosveprimit, e po që se pala më vonë ka mësuar për mosveprimin, atëherë afati llogaritet nga dita kur ka mësuar për mosveprimin. Nga kjo rezulton se pala paditëse faktikisht ka qenë në dijeni për mbajtjen e seancës së shqyrtimit kryesor me dt. 13.10.2014, gjersa aktvendimi mbi konstatimin e tërheqjes së padisë pala paditëse e ka pranuar me dt. 21.10.2014, që do të thotë se pala paditëse kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme e ka ushtuar pas afatit prej 7 ditësh, ngase afati i fundit ligjor për ushtrimin e kërkesës për përsëritje të procedurës ka qenë me dt. 28.10.2014, andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar e ka hedhë poshtë si të pasafatshme kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme.

Duke marr parasysh pretendimet ankimore të cilat konsistojnë ndaj aktvendimeve të ankimuara, gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendime ankimore janë të pabazuara ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194, të LPK-së. Andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vendos kur e ka konsideruar si të tërhequr padinë e paditësit, dhe njëherit kur me aktvendim e ka hedhë si të pasafatshme kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS NË PRISHTINË,

AC.nr.4889/14 me dt. 07.12.2016

KRYETARI I KOLEGJIT-GJYQTARI

Hasan Shala